

Universiteti i Elbasanit zhvillon takimim e parë në kuadër të Bordit Këshillimor me Elite Travel Group

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", zhvilloi takimim e parë në kuadër të Bordit Këshillimor të Biznesit në bashkëpunim me Sektorin e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.

Përfaqësues të Elite Travel Group zhvilluan me studentë të programeve të ndryshme të studimit një takim me qëllim informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre, për rëndësinë dhe potencialin e turizmit në vendin tonë, si dhe mundësitë që ofron ky sektor për krijimin e vendeve të reja të punës. Gjithashtu u theksua nevoja për orientimin e studentëve në këtë sektor për t'ju dhënë atyre mundësinë që të qendrojnë dhe të investojnë në zhvillimin e tyre dhe të vendit.

Universiteti i Elbasanit prej vitesh ka lidhur marrëveshje me bizneset më prestigjioze të Qarkut të Elbasanit, për t'ju ardhur në ndihmë studentëve me workshope, trajnime, projekte apo mundësi punësimi.



